



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH. nr. 865/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Goran Mileković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE “Miniverse”shpk- Prishtinë, kundër njoftimit për konkursin e projektimit me titull: “Konkurs projektimi për hartimin e Projektit Konservimi dhe adaptimi i ndërtesës së ish-Kadastrit”, me numër të prok: 616-19-5638-4-2-3, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Prishtinë, më datë: 13.01.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Miniverse” shpk-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Konkurs projektimi për hartimin e Projektit Konservimi dhe adaptimi i ndërtesës së ish-Kadastrit”, me numër të prok: 616-19-5638-4-2-3, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/, Kuvendi Komunal Prishtinë.

II. ANULOHET, Njoftimi për konkursin e projektimit me titull: “Konkurs projektimi për hartimin e Projektit Konservimi dhe adaptimi i ndërtesës së ish-Kadastrit”, me numër të prok:616-19-5638-4-2-3, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/, Kuvendi Komunal Prishtinë, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Miniverse”shpk- Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i deponitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues: “Miniverse”shpk- Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me dt. 02.12.2019 , me nr. 865/19, kundër njoftimit për konkursin e projektimit me titull: “Konkurs projektimi për hartimin e Projektit Konservimi dhe adaptimi i ndërtesës se ish-Kadastrit”, me numër të prok: 616-19-5638-4-2-3, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/Kuvendi Komunal Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin : 1, 7, 59 dhe 80 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe nenin 57.26 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 12.12.2019, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 30.12.2019 sqaron si në vijim :

PRETENDIMI NR. 1

Lidhur me pretendimin e OE ” Miniverse” sh.p.k. – ankues se si juria me anë të vlerësimit të projektit të Operatorit Ekonomik me shifër 5044, me pikë në vendin e dytë bie në kundërshtim me kërkesat - Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE dhe/ose estetike TË DETYRUESHME - detyrës projektuese për konservimin dhe adaptimin e ndërtesës si dhe me parimet themelore profesionale të konservimit të monumenteve, me Ligjin nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore,dhe atë: Vendosija e liftit hidraulik në monument- Integrimi i liftit hidraulik në mes të hapësirës së shkallëve, të cilën e parasheh projekt

propozim është e pamundur për tu realizuar. Fillimisht për çështje konstruktive, sepse hapësira që kërkohet për lift hidraulik për persona me nevoja të veçanta është minimalisht 3m2, ndërsa realisht aty kemi vetën 0.5 m2. Nëse veç mendohet ky opsion, duhet që struktura e shkallëve ekzistuese nga beton armeja të shembet, të zvogëlohen dhe t'i jepet hapësirë vendosjes së liftit. (Kjo mund të rezultojë me shembjen totale të ndërtesës sepse shkallët janë bërthama e saj)

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN NR. 1

Gjatë analizës së detyrës projektuese, projektit të propozuar si dhe ligjit për Trashëgimin Kulturore Eksperti shqyrtues konstaton se operatori ekonomik gjatë hartimit të projektit nuk e ka respektuar detyrën projektuese në bazë të cilës kërkohet :”Të ruhet struktura ekzistuese, të trajtohen vetëm dëmtimet në strukturë. Nëse ka nevojë muret e brendshme mund të largohen për arsyeje të shfrytëzimit të hapësirave, natyrisht duhet që paraprakisht të bëhet analiza e materialeve dhe statikës për ato mure; pra OE- shifra 5044 nuk e ka respektuar këtë kriter dhe shkallet si element strukturor dhe element përbërës i trashëgimisë i demolon dhe ofron zgjidhje të re të shkalleve ku në mes të tyre e vendos liftin me këtë rast e dëmton strukturën e objektit si dhe formën e shkalleve si element për bërës trashëgimor njëherit demolimi i shkalleve si element origjinal strukturor dhe përbërës i trashëgimisë kulturore është në kundërshtim me ligjin për Trashëgiminë Kulturore nr. 02/L-88 përkatësisht neni 6 .paragrafi 6.3ku thuhet-Monumentet arkitekturale ruhen në të gjitha elementet e tyre përbërëse, tiparet arkitekturale dhe teknike. dhe paragrafin 6.11 ku thuhet:- Ndalohet lëvizja apo zhvendosja e pjeshme ose complete e ndonjë pjesë të trashëgimisë së mbrojtur arkitekturale nën mbrojtje të përkohshme apo të përhershme.

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

PRETENDIMI NR.2

Lidhur me pretendimin e OE ” Miniverse” sh.p.k. – ankues se si juria me anë të vlerësimit të projektit të Operatorit Ekonomik me shifër 5044, me pikë në vendin e dytë bie në kundërshtim me kërkesat - Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE dhe/ose estetike TË DETYRUESHME - detyrës projektuese për konservimin dhe adaptimin e ndërtesës si dhe me parimet themelore profesionale të konservimit të monumenteve, me Ligjin nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore, dhe atë: “Krijimi i hapësirës ajrore në monument - Projekti parasheh krijimin e një hapësirë ajrore në mes të katit. Për krijimin e kësaj hapësire ajrore, duhet të demolohet konstruksioni mes katesh, duhet që një pjesë e konsiderueshme e strukturës së monumentit (dyshemesë së katit) të shembet dhe të largohet. Kjo pra nuk garanton që monumenti nuk mund të rrënohet i tëri”

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN NR.2

Gjate analizës se detyrës projektuese ligjit për Trashëgimin Kulturore , si dhe projektit te propozuar

Eksperti shqyrtues konstaton se operatori ekonomik gjate hartimit te projektit nuk e ka respektuar detyrën projektuese ne baze te cilës kërkohet-Përmirësimi i gjendjes ekzistuese të ndërtesës- trajtimi i dëmtimeve duke ruajtur elementet origjinale të saj. – si dhe kërkeshën:Të ruhet struktura ekzistuese, të trajtohen vetëm dëmtimet në strukturë. Prandaj operatori ekonomik ne propozim projektin e tij bene hapjen e konstruksionit te pllakës se meskatit për formimin e hapësirës ajrore në mes të dy etazheve, me të cilën e dëmton rend strukturën e objektit pra të pllakës së mes katit si pjesë përbërëse e trashëgimisë kulturore, duke ndikuar drejtpërsëdrejti në stabilitetin e objektit si dhe ndërhyrje nëpjesëpërbërëse te trashëgimisë.

Sipas RRUOPP , nenit 39. Sqarimi i Tenderëve thuhet nëse mungon specifikacioni teknik (i detyrueshëm) – refuzo tenderin pa kërkuar informacione te mëtejshme.

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

PRETENDIMI NR.3

Lidhur me pretendimin e OE ” Miniverse” sh.p.k. – ankues se si juria me anë të vlerësimit të projektit të Operatorit Ekonomik me shifër 5044, me pikë në vendin e dytë bie në kundërshtim me kërkesat - Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE dhe/ose estetike TË DETYRUESHME - detyrës projektuese për konservimin dhe adaptimin e ndërtesës dhe atë: Adaptimi i anekseve në afërsi të monumentit- Adaptimi i anekseve që gjenden në rrethinë të monumentit, siç e propozon ky OE është në kundërshtim me rezultatet e pritura nga projekti (siç përshkruhet në detyrë projektuese) ku thuhet: -Largimi i anekseve të cilat ndodhen në zonën e mbrojtur të ndërtesës dhe që me arkitekturën e tyre ndikojnë negativisht në integritetin e ndërtesës në zonën historike;

Sikurse është në kundërshtim me kërkesat specifike të dizajnit në detyrë projektuese, ku thuhet:-Të largohen anekset e ndërtuara më vonë dhe të kthehet hapësira përreth ndërtesës në hapësirë publike të gjelbëruar që mund të përdoret nga të gjitha komunitetet.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN NR.3

Gjate analizës se detyrës projektuese ligjit për Trashëgimin Kulturore , si dhe projektit të propozuar Eksperti shqyrtues konstaton se operatori ekonomik gjatë hartimit të projektit nuk e ka respektuar detyrën projektuese në bazë të cilën kërkohet: Largimi i anekseve të cilat ndodhen në zonën e mbrojtur të ndërtesës dhe që me arkitekturën e tyre ndikojnë negativisht në integritetin e ndërtesës në zonën historike

Sipas RrUOPP , nenit 39. Sqarimi i Tenderëve thuhet nëse mungon specifikacioni teknik (i detyrueshëm) – refuzo tenderin pa kërkuar informacione te mëtejshme.

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

PRETENDIMI NR.4

Lidhur me pretendimin e OE "Miniverse" sh.p.k. – ankues se si juria me anë të vlerësimit të projektit të Operatorit Ekonomik me shifër 5044, me pikë në vendin e dytë bie në kundërshtim me kërkesat - Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE dhe/ose estetike TË DETYRUESHME - detyrës projektuese për konservimin dhe adaptimin e ndërtesës dhe atë: Mungesa e nyjve sanitare në katin e parë - Ky projekt gjithashtu nuk ofron zgjidhje funksionale në nivelin e katit të parë, që do të shfrytëzohet për qëllime administrative.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN NR.4

Gjate analizës së detyrës projektuese ligjit për Trashëgimin Kulturorë , si dhe projektit të propozuar Eksperti shqyrtues konstaton se operatori ekonomik gjatë hartimit të projekt propozimit nuk e ka respektuar detyrën projektuese në bazë të cilës kërkohet: - Në katin e parë duhet të parashihet një sallë takimesh dhe kuzhinë e përbashkët, si dhe nyjet sanitare për të dy gjinitë pra në specifikimin teknik të detyrueshëm është përcaktuar në mënyrë decisive që të parashihen këto kthina të cila OE nuk i ka paraparë në zgjidhjen e ofruar.

Sipas RRUOPP , nenit 39. Sqarimi i Tenderëve thuhet nëse mungon specifikacioni teknik (i detyrueshëm) – refuzo tenderin pa kërkuar informacione të mëtejshme.

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

PRETENDIMI NR.5

Lidhur me pretendimin e OE "Miniverse" sh.p.k. – ankues se si juria me anë të vlerësimit të projektit të Operatorit Ekonomik me shifër 5044, me pikë në vendin e dytë bie në kundërshtim me kërkesat - Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE dhe/ose estetike TË DETYRUESHME - detyrës projektuese për konservimin dhe adaptimin e ndërtesës dhe atë:Zgjidhje jo-funksionale në përdhese - Po ashtu projekti parasheh zgjidhje jo të duhur në nyjet sanitare në nivelin e katit përdhe.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN NR.5

Gjate analizës së detyrës projektuese ligjit për Trashëgimin Kulturorë , si dhe projektit të propozuar Eksperti shqyrtues konstaton se operatori ekonomik gjatë hartimit të projektit nuk e ka respektuar detyrën projektuese në bazë të cilës kërkohet që *“të projektohen nyjet sanitare, të ndara për të dy gjinitë dhe personat me aftësi të kufizuar”* pra OE në zgjidhjen e projektit të ofruar nuk ka ofruar qasje sipas kërkesë për nyjet sanitare sepse nyjën sanitare të femrave dhe atë për persona me aftësi të kufizuar i ka për mes hapësirës për lavaman të nyjës sanitare të femrave si dhe në bazë të rregulloreve nyja sanitare për personat me aftësi të kufizuar duhet të jetë me dimensione minimale (1.70x1.70)m si dhe duke llogaritur trashësinë e murit ndarës në mesë të kësaj nyje sanitare dhe ËC-se se femrave me panel

minimum prej 5.0cm atëherë gjerësia e EC-se femrave do të jetë 0.75m e cila gjerësi është e vogël për shfrytëzim normal, kur dihet se gjerësia e kësaj hapësire në gjendjen ekzistuese e paraparë për këto dy nyje sanitare në mes të mureve të cilat nuk do të rriten është 2.50 m.

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

PRETENDIMI NR.6

Lidhur me pretendimin e OE "Miniverse" sh.p.k. – ankues se si juria me anë të vlerësimit të projektit të Operatorit Ekonomik me shifër 5044, me pikë në vendin e dytë bie në kundërshtim me kërkesat - Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE dhe/ose estetike TË DETYRUESHME - detyrës projektuese për konservimin dhe adaptimin e ndërtesës dhe atë: Në hapësirën e katit përdhes duhet të parashihet recepsioni i hapur ku do të duhet të qëndroj roja.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN NR.6

Gjate analizës së detyrës projektuese ligjit për Trashëgimin Kulturore , si dhe projektit të propozuar Eksperti shqyrtues konstaton se operatori ekonomik gjatë hartimit të projektit nuk e ka respektuar detyrën projektuese në bazë të cilës kërkohet qenë hapësirën e katit përdhe ku duhet të parashihet recepsioni i hapur ku do të duhet të qëndroj roja. Sepse në projektin e propozuar nuk e ka specifikuar në mënyrën e kërkuar në bazë të specifikacionit teknik të detyrueshëm pjesën e recepcionit në të cilin do të qëndroj roja për monitorimin e objektit.

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

PRETENDIMI NR.7

Lidhur me pretendimin e OE "Miniverse" sh.p.k. – ankues se si juria me anë të vlerësimit të projektit të Operatorit Ekonomik me shifër 5044, me pikë në vendin e dytë bie në kundërshtim me kërkesat - Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE dhe/ose estetike TË DETYRUESHME - detyrës projektuese për konservimin dhe adaptimin e ndërtesës dhe atë: Jo qasje për persona me aftësi të kufizuar (PAK).

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN NR.7

Gjate analizës së detyrës projektuese ligjit për Trashëgimin Kulturore , si dhe projektit të propozuar Eksperti shqyrtues konstaton se operatori ekonomik gjatë hartimit të projektit pjesërisht e ka respektuar detyrën projektuese në bazë të cilës kërkohet që: Dizajni dhe format e integruara të jenë në përputhje me parimet e përgjithshme për qasje universale. OE në projektin e propozuar ka paraparë që qasja në objekt të bëhet përmes një rampe të formuar në oborrin e objektit për të cilën nuk i ka të përcaktuara të dhënat e nevojshme si përqindjen e pjerrtësisë , gjatësinë e rampës, fillimin dhe mbarimin e saj.

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është pjesërisht i bazuar.

PERGJIGJET NE PRETENDIMET ANKIMORE TE OE ANKUES ME SHIFER 8401 PER PROJEKT PROPOZIMIN E OE ME SHIFER 2107

PRETENDIMI NR.1

Lidhur me pretendimin e OE "Miniverse" sh.p.k. – ankues se si juria me anë të vlerësimit të projektit të Operatorit Ekonomik me shifër 2107, me pikë në vendin e parë bie në kundërshtim me kërkesat - Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE dhe/ose estetike TË DETYRUESHME - detyrës projektuese për konservimin dhe adaptimin e ndërtesës si dhe me parimet themelore profesionale të konservimit të monumenteve, me Ligjin nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore, dhe atë: Ndërtimi i objektit ngjitur për monument/ Info-point.

PERGJIGJE NË PRETENDIMIN NR.1

Gjatë analizës së detyrës projektuese ligjit për Trashëgiminë Kulturore, si dhe projektit të propozuar Eksperti shqyrtues konstaton se operatori ekonomik gjatë hartimit të projektit nuk e ka respektuar detyrën projektuese në bazë të së cilës kërkohet që të bëhet: Largimi i anekseve të cilat ndodhen në zonën e mbrojtur të ndërtesës dhe që me arkitekturën e tyre ndikojnë negativisht në integritetin e ndërtesës në zonën historike, kurse OE me shifër 2107 në projekt propozimin e dorëzuar nuk i respekton kriteret të kërkuara me specifikacionin teknik të detyrueshëm- tek Detyra projektuese respektivisht Kërkesat specifike të Dizajnit në të cilën kërkohet: Të largohen anekset e ndërtuara më vonë dhe të kthehet hapësira përreth ndërtesës në hapësirë publike të gjelbëruar që mund të përdoret nga të gjitha komunitetet, kurse OE me shifër 2107 në projekt propozimin e dorëzua para sheh që në këtë zonë të ndërtojë një objekt me funksion për "InfoPoint" i cili është propozuar që të jetë i ngjitur me objektin cili është në mbrojtje të trashëgimisë kulturore kështu që ndikon drejtpërsëdrejti në integritetin e ndërtesës si dhe në fshehjen e detajeve arkitekturore të trashëgimisë.

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

PRETENDIMI NR.2

Lidhur me pretendimin e OE "Miniverse" sh.p.k. – ankues se si juria me anë të vlerësimit të projektit të Operatorit Ekonomik me shifër 2107, me pikë në vendin e parë bie në kundërshtim me kërkesat - Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE dhe/ose estetike TË DETYRUESHME - detyrës projektuese për konservimin dhe adaptimin e ndërtesës si dhe me parimet themelore profesionale të konservimit të

monumenteve, me Ligjin nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore, dhe atë :Ri- adaptimi i lokaleve- ndërtimi i lokaleve te reja.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN NR.2

Gjate analizës së detyrës projektuese ligjit për Trashëgiminë Kulturore , si dhe projektit të propozuar Eksperti shqyrtues konstaton se operatori ekonomik gjatë hartimit të projektit nuk e ka respektuar detyrën projektuese në bazë të së cilës kërkohet që të bëhet - Largimi i anekseve të cilat ndodhen në zonën e mbrojtur të ndërtesës dhe që me arkitekturën e tyre ndikojnë negativisht në integritetin e ndërtesës në zonën historike; kurse OE me shifër 2107 në projekt propozimin e dorëzuar nuk i respekton kriteret të kërkuara me specifikacionin teknik të detyrueshëm- tek Detyra projektuese respektivisht Kërkesat specifike të Dizajnit në të cilën kërkohet: Të largohen anekset e ndërtuara më vonë dhe të kthehet hapësira përreth ndërtesës në hapësirë publike të gjelbëruar që mund të përdoret nga të gjitha komunitetet, kurse OE me shifër 2107 ne projekt propozimin e dorëzuar parasheh që në këtë zonë të ndërtoj objekte apo ti Ri- adaptoj ato ekzistueset.

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

PRETENDIMI NR.3

Lidhur me pretendimin e OE "Miniverse" sh.p.k. – ankues se si juria me anë të vlerësimit të projektit të Operatorit Ekonomik me shifër 2107, me pikë në vendin e parë bie në kundërshtim me kërkesat - Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE dhe/ose estetike TË DETYRUESHME - detyrës projektuese për konservimin dhe adaptimin e ndërtesës si dhe me parimet themelore profesionale të konservimit të monumenteve, me Ligjin nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore, dhe atë : Vendosja e gardheve në hapësirë publike.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN NR.3

Gjate analizës së detyrës projektuese ligjit për Trashëgiminë Kulturore , si dhe projektit të propozuar Eksperti shqyrtues konstaton se operatori ekonomik gjatë hartimit të projektit nuk e ka respektuar detyrën projektuese në bazë të së cilës kërkohet që të Krijohen hapësira publike të gjelbëruar në mjedisin përreth ndërtesës si dhe të largohen anekset e ndërtuara më vonë dhe të kthehet hapësira përreth ndërtesës në hapësirë publike të gjelbëruar që mund të përdoret nga të gjitha komunitetet dhe jo te kufizohet me gardhe apo të bëhet ndarja me rrethoj e dy objekteve të trashëgimisë kulturore siç është objekti i Ish kadastrit dhe ai i shkollës së parë shqipe.

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

PRETENDIMI NR.4

Lidhur me pretendimin e OE "Miniverse" sh.p.k. – ankues se si juria me anë të vlerësimit të projektit të Operatorit Ekonomik me shifër 2107, me pikë në vendin e parë bie në kundërshtim me kërkesat - Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE dhe/ose estetike TË DETYRUESHME - detyrës projektuese për konservimin dhe adaptimin e ndërtesës si dhe me parimet themelore profesionale të konservimit të monumenteve, me Ligjin nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore, dhe atë: Shtimi i funksioneve jashtë kërkesës së detyrës projektuese **PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN NR.4**

Gjate analizës së detyrës projektuese, si dhe projektit të propozuar Eksperti shqyrtues konstaton se operatori ekonomik gjatë hartimit të projektit e ka respektuar detyrën projektuese në bazë të se cilës janë përcaktuar hapësirat të cilat duhet përmbaj zgjidhja e propozuar duke e respektuar sipërfaqen e vogël shfrytëzuese të objektit operatori ekonomik nëprojektin e propozuar ka paraparëkthina të cilat janë të nevojshme për plotësimin e nevojave për këtë lloj objekti,

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

PRETENDIMI NR.5

Lidhur me pretendimin e OE "Miniverse" sh.p.k. – ankues se si juria me anë të vlerësimit të projektit të Operatorit Ekonomik me shifër 2107, me pikë në vendin e parë bie në kundërshtim me kërkesat - Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE dhe/ose estetike TË DETYRUESHME - detyrës projektuese për konservimin dhe adaptimin e ndërtesës si dhe me parimet themelore profesionale të konservimit të monumenteve, me Ligjin nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore, dhe atë: Parkingu nëntokësorë në parcelën e Komunës së Prishtinës

PËRGJIGJE NË PRETENDIMIN NR.5

Gjate analizës së detyrës projektuese ligjit për Trashëgiminë Kulturore , si dhe projektit të propozuar Eksperti shqyrtues konstaton se operatori ekonomik gjatë hartimit të projektit nuk e ka respektuar detyrën projektuese sepse parcela për trajtim që është dhënë me detyrën projektuese është e vogël për të paraparë parking nëntokësor njëherit kjo është zonë trashëgimisë kulturore në të cilën nuk lejohet të ndërtohen objekte të reja dhe sipas detyrës projektuese është kërkuar të bëhet Largimi i anekseve të cilat ndodhen në zonën e mbrojtur të ndërtesës dhe që me arkitekturën e tyre ndikojnë negativisht në integritetin e ndërtesës në zonën historike

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar

PRETENDIMI NR.6 /Mospërputhje në mes të pikëve dhe arsyeve të dhëna në raportin e vlerësimit/

Lidhur me pretendimin e OE "Miniverse" s.hp.k. – ankues se Autoriteti Kontraktues-juria, në raportin e vlerësimit ka trajtim të pabarabartë dhe indikativ ndaj nesh si Operatorë Ekonomik 8041. Përderisa arsyet e poentimit duhet që të reflektojnë në numrin e poenave për secilit operatorë, te ne- Operatori Ekonomik 8041, ndodhë e kundërta! Edhe pse në arsyet e poentimit thuhet se i kemi përmbushur Kriterin

Estetik dhe Ekologjik, poentohemi me më pak pikë se OE 5044, që thuhet se nuk e ka përmbushur këtë kriter. Kjo ndodhë edhe në Kriterin Hapësinorë, ku Operatori 5044 nuk përmbushë këtë kriter dhe prapë i ipen më shumë pikë se ne (8401)- që e përmbushim këtë kriter (Shih këtë në aneksin e bashkangjitur faqe 6 dhe 7). Kjo pabarazi në vlerësim, kjo mos-përputhje ka ndikuar që OE 5044 në mënyrë jo meritore të ketë më shumë pikë dhe të rreshtohet para nesh (në vend të dytë)

PËRGJIGJE NË PRETENDIMI NR.6

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues se AK- juria e ka vlerësuar me më pakë pikë se sa OE shifra 5044 dhe pse thuhet se i kemi përmbushur Kriterin Estetik dhe Ekologjik, poentohemi me më pak pikë se shifra 5044 , gjatë analizës së raportit të vlerësimit të jurisë respektivisht Arsyet e poentimit për Kriter Estetik (vlera në pikë = 20 pikë) shifra 5044 vlerësohet : “Vlera dhe origjinaliteti i trashëgimisë arkitektonike të ndërtesës në fjalë sipas projektit. Në dukjen e jashtme dhe pjesërisht të brendshme është arrit të respektohet mesatarisht brenda kontekstit kulturor të cilit i përket, si dhe duke u bazuar në dokumentet e gjetura me të cilat posedojnë institucionet relevante të trashëgimisë” dhe poentohet me pikë mesatare të tre anëtarëve të Jurisë $\{(14+12+14)/3= 13.33 \text{ pike}\}$. Kurse Operatori Ekonomik me shifër 8041 vendin e dytë e vlerësohet: “Vlera dhe origjinaliteti i trashëgimisë arkitektonike të ndërtesës në fjalë sipas projektit në dukjen e jashtme respektivisht dukja - modeli i dritareve të propozuara nuk respekton dukjen autentike duke u bazuar në dokumentet e gjetura me të cilat posedojnë institucionet relevante të trashëgimisë. pjesët tjera përbërëse të dukjes përshtaten me kriteret e ruajtjes dhe është e pranueshme.” Poentohet me pikë mesatare të tre anëtarëve të Jurisë $\{(15+15+15)/3= 15 \text{ pikë}\}$

Eksperti shqyrtues në bazë të vlerësimit të bërë nga komisioni për vlerësim të Kriterit Estetik të projektit të dorëzuar nga Operatori Ekonomik ”Miniverse” sh.p.k. me shifër 8041 me 13.33 pikë nga 20 pikë të peshuara për këtë kriter i cili vlerësohet në këtë mënyrë: “...është arrit të respektohet mesatarisht brenda kontekstit kulturor ...” Mendon është dashtë të vlerësohet me pikë më shumë se sa projekt propozimi Operatorit Ekonomik me shifër 5044 per kriterin Estetik dhe Ekologjik te cilin komisioni e ka vlerësuar:”... nuk respekton dukjen autentike duke u bazuar ne dokumentet e gjetura me të cilat posedojnë e institucionet relevante të trashëgimisë ...” dhe të cilën e ka vlerësuar me 15 pikë nga 20 pikë të peshuara për këtë kriter.

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, të anulohet njoftimi për

rezultatet e projektimit – rezultatet e vlerësimit artistik dhe rekomandon që lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 23.12.2019, me anë të shkresës zyrtare është njoftuar nga OSHP lidhur me mendimin e ekspertit dhe i njëjti ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues teknik.

Operatori Ekonomik, me datë: 01.01.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues teknik.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën:13.01.2020, pa praninë e palëve konform nenit 26.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konform mendimit të ekspertit shqyrtues teknik konstaton se pretendimi ankimor i OE ankues "Miniverse" sh.p.k. – ankues se juria me anë të vlerësimit të projektit të Operatorit Ekonomik me shifër 5044, me pikë në vendin e dytë bie në kundërshtim me kërkesat - Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE dhe/ose estetike TË DETYRUESHME - detyrës projektuese për konservimin dhe adaptimin e ndërtesës si dhe me parimet themelore profesionale të konservimit të monumenteve, me Ligjin nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore dhe atë: Vendosija e liftit hidraulik në monument- Integrimi i liftit hidraulik në mes të hapësirës së shkallëve, të cilën e parasheh projekt propozim është e pamundur për tu realizuar. Fillimisht për çështje konstruktive, sepse hapësira që kërkohet për lift hidraulik për persona me nevoja të veçanta është minimalisht 3m², ndërsa realisht aty kemi vetën 0.5 m². Nëse veç mendohet ky opsion, duhet që struktura e shkallëve ekzistuese nga beton armeja të shembet, të zvogëlohen dhe t'i jepet hapësirë vendosjes së liftit. (Kjo mund të rezultojë me shembjen totale të ndërtesës sepse shkallët janë bërthama e saj), është i qëndrueshëm për faktin se operatori ekonomik gjatë hartimit të projektit nuk e ka respektuar detyrën

projektuese në bazë të cilës kërkohet: "Të ruhet struktura ekzistuese, të trajtohen vetëm dëmtimet në strukturë. Nëse ka nevojë muret e brendshme mund të largohen për arsyeje të shfrytëzimit të hapësirave, natyrisht duhet që paraprakisht të bëhet analiza e materialeve dhe statikës për ato mure; pra OE- shifra 5044 nuk e ka respektuar këtë kriter dhe shkallet si element strukturor dhe element përbërës i trashëgimisë i demolon dhe ofron zgjidhje të re të shkalleve ku në mes të tyre e vendos liftin me këtë rast e dëmton strukturën e objektit si dhe formën e shkallevesi element për bërës trashëgimor njëherit demolimi i shkalleve si element origjinal strukturor dhe përbërës i trashëgimisë kulturore është në kundërshtim me ligjin për Trashëgiminë Kulturore nr. 02/L-88 përkatësisht neni 6 paragrafi 6.3 ku thuhet- Monumentet arkitekturale ruhen në të gjitha elementet e tyre përbërëse, tiparet arkitekturale dhe teknike. dhe paragrafin 6.11 ku thuhet: Ndalohet lëvizja apo zhvendosja e pjeshme ose complete e ndonjë pjesë të trashëgimisë së mbrojtur arkitekturale nën mbrojtje të përkohshme apo të përhershme.

Lidhur me pretendimin e OE "Miniverse" sh.p.k. – ankues vendimi i jurisë me anë të vlerësimit të projektit të Operatorit Ekonomik me shifër 5044, me pikë në vendin e dytë është në kundërshtim me kërkesat - Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE dhe/ose estetike TË DETYRUESHME - detyrës projektuese për konservimin dhe adaptimin e ndërtesës si dhe me parimet themelore profesionale të konservimit të monumenteve, me Ligjin nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore, dhe atë: "Krijimi i hapësirës ajrore në monument- Projekti parasheh krijimin e një hapësirë ajrore në mes të katit. Për krijimin e kësaj hapësirë ajrore, duhet të demolohej konstruksioni mes katesh, duhet që një pjesë e konsiderueshme e strukturës së monumentit (dyshemesë së katit) të shembet dhe të largohet. Kjo pra nuk garanton që monumenti nuk mund të rrënohet i tëri", paneli shqyrtues konform mendimit të ekspertit shqyrtues teknik konstaton se duke u bazuar në nenin 39- Sqarimi i Tenderëve RRUOPP ku thuhet: nëse mungon specifikacioni teknik (i detyrueshëm) – refuzo tenderin pa kërkuar informacione të mëtejshme, pretendimi ankimor i OE ankues është i qëndrueshëm për faktin se është konstatuar se operatori ekonomik gjate hartimit të projektit nuk e ka respektuar detyrën projektuese në baze të cilës kërkohet- Përmirësimi i gjendjes ekzistuese të ndërtesës- trajtimi i dëmtimeve duke ruajtur elementet origjinale të saj. – si dhe kërkesën: Të ruhet struktura ekzistuese, të trajtohen vetëm dëmtimet në strukturë. Prandaj operatori ekonomik në propozim projektin e tij bene hapjen e konstruksionit të pllakës së meskatit për formimin e hapësirës ajrore në mes të dy etazheve, me të cilën e dëmton rend strukturën e objektit pra të pllakës së mes katit si pjesë përbërëse e trashëgimisë kulturore, duke ndikuar drejtpërsëdrejti në stabilitetin e objektit si dhe ndërhyrje në pjesën përbërëse të trashëgimisë.

Sa i përket pretendimit të OE "Miniverse" sh.p.k. se juria me anë të vlerësimit të projektit të Operatorit

Ekonomik me shifër 5044, ka rënë në kundërshtim me kërkesat - Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE dhe/ose estetike TË DETYRUESHME - detyrës projektuese për konservimin dhe adaptimin e ndërtesës dhe atë: Adaptimi i anekseve në afërsi të monumentit- Adaptimi i anekseve që gjenden në rrethinë të monumentit, siç e propozon ky OE është në kundërshtim me rezultatet e pritura nga projekti (siç përshkruhet në detyrë projektuese) ku thuhet: -Largimi i anekseve të cilat ndodhen në zonën e mbrojtur të ndërtesës dhe që me arkitekturën e tyre ndikojnë negativisht në integritetin e ndërtesës në zonën historike; Sikurse është në kundërshtim me kërkesat specifike të dizajnit në detyrë projektuese, ku thuhet:-Të largohen anekset e ndërtuara më vonë dhe të kthehet hapësira përreth ndërtesës në hapësirë publike të gjelbëruar që mund të përdoret nga të gjitha komunitetet, paneli shqyrtues konform mendimit të dhënë nga eksperti shqyrtues teknik konstaton pas analizës se detyrës projektuese të ligjit për Trashëgimin Kulturore, si dhe projektit të propozuar rezulton se operatori ekonomik gjatë hartimit të projektit nuk e ka respektuar detyrën projektuese në bazë të cilën kërkohet: Largimi i anekseve të cilat ndodhen në zonën e mbrojtur të ndërtesës dhe që me arkitekturën e tyre ndikojnë negativisht në integritetin e ndërtesës në zonën historike, e që sipas nenit 39- sqarimi i tenderëve në mungesë të specifikacionit duhet të refuzohet pa kërkuar informacione të mëtutjeshme.

Në lidhje me pretendimin e OE "Miniverse" sh.p.k. – ankues se juria me anë të vlerësimit të projektit të Operatorit Ekonomik me shifër 5044, me pikë në vendin e dytë ka rënë në kundërshtim me kërkesat - Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE dhe/ose estetike TË DETYRUESHME - detyrës projektuese për konservimin dhe adaptimin e ndërtesës dhe atë: Mungesa e njeve sanitare në katin e parë - Ky projekt gjithashtu nuk ofron zgjidhje funksionale në nivelin e katit të parë, që do të shfrytëzohet për qëllime administrative, paneli shqyrtues konform mendimit të ekspertit shqyrtues teknik konstaton se pas analizës së projektit të propozuar rezulton se operatori ekonomik gjatë hartimit të projekt propozimit nuk e ka respektuar detyrën projektuese në bazë të cilës kërkohet: - Në katin e parë duhet të parashihet një sallë takimesh dhe kuzhinë e përbashkët, si dhe nyjet sanitare për të dy gjinitë pra në specifikimin teknik të detyrueshëm është përcaktuar në mënyrë decisive që të parashihen këto kthina të cila OE nuk i ka paraparë në zgjidhjen e ofruar, andaj ky pretendim ankimor i OE ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE "Miniverse" sh.p.k. – ankues se si juria me anë të vlerësimit të projektit të Operatorit Ekonomik me shifër 5044, me pikë në vendin e dytë bie në kundërshtim me kërkesat - Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE dhe/ose estetike TË DETYRUESHME - detyrës projektuese për konservimin dhe adaptimin e ndërtesës dhe atë: Zgjidhje jo-funksionale në përdhese - Po ashtu projekti parasheh zgjidhje jo të duhur në nyjet sanitare në nivelin e katit përdhese, paneli shqyrtues konform

mendimit të ekspertit shqyrtues teknik konstaton se operatori ekonomik gjatë hartimit të projektit nuk e ka respektuar detyrën projektuese në bazë të cilës kërkohet që *“të projektohen nyjet sanitare, të ndara për të dy gjinitë dhe personat me aftësi të kufizuar”* pra OE në zgjidhjen e projektit të ofruar nuk ka ofruar qasje sipas kërkesë për nyjet sanitare sepse nyjën sanitare të femrave dhe atë për persona me aftësi të kufizuar i ka për mes hapësirës për lavaman të nyjës sanitare të femrave si dhe në bazë të rregulloreve nyja sanitare për personat me aftësi të kufizuar duhet të jetë me dimensione minimale (1.70x1.70)m si dhe duke llogaritur trashësinë e murit ndarës në mes të kësaj nyje sanitare dhe ËC-se se femrave me panel minimum prej 5.0cm atëherë gjerësia e ËC-se femrave do të jetë 0.75m e cila gjerësi është e vogël për shfrytëzim normal, kur dihet se gjerësia e kësaj hapësire në gjendjen ekzistuese e paraparë për këto dy nyje sanitare në mes të mureve të cilat nuk do të rrenohen është 2.50 m. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura paneli shqyrtues konstaton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ” Miniverse” sh.p.k. – ankues se si juria me anë të vlerësimit të projektit të Operatorit Ekonomik me shifër 5044, me pikë në vendin e dytë bie në kundërshtim me kërkesat - Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE dhe/ose estetike TË DETYRUESHME - detyrës projektuese për konservimin dhe adaptimin e ndërtesës dhe atë: Në hapësirën e katit përdhes duhet të parashihet recepsioni i hapur ku do të duhet të qëndroj roja, paneli shqyrtues konform mendimit të ekspertit shqyrtues teknik konstaton se operatori ekonomik gjatë hartimit të projektit nuk e ka respektuar detyrën projektuese në bazë të cilës kërkohet që në hapësirën e katit përdhe ku duhet të parashihet recepsioni i hapur ku do të duhet të qëndroj roja. Sepse në projektin e propozuar nuk e ka specifikuar në mënyrën e kërkuar në bazë të specifikacionit teknik të detyrueshëm pjesën e recepcionit në të cilin do të qëndroj roja për monitorimin e objektit, andaj edhe ky pretendim ankimor, është i qëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin e OE ” Miniverse” sh.p.k. – ankues se si juria me anë të vlerësimit të projektit të Operatorit Ekonomik me shifër 5044, me pikë në vendin e dytë bie në kundërshtim me kërkesat - Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE dhe/ose estetike TË DETYRUESHME - detyrës projektuese për konservimin dhe adaptimin e ndërtesës dhe atë: Jo qasje për persona me aftësi të kufizuar (PAK), paneli shqyrtues konstaton se operatori ekonomik gjatë hartimit të projektit pjesërisht e ka respektuar detyrën projektuese në bazë të cilës kërkohet që: Dizajni dhe format e integruara të jenë në përputhje me parimet e përgjithshme për qasje universale. OE në projektin e propozuar ka paraparë që qasja në objekt të bëhet përmes një rampe të formuar në oborrin e objektit për të cilën nuk i ka të përcaktuara të dhënat e nevojshme si përqindjen e pjerrtësisë, gjatësinë e rampës, fillimin dhe mbarimin e saj, andaj pretendimi ankimor është i bazuar.

Paneli shqyrtues ka dhënë sqarime dhe në pretendimet ankimore të OE ankues “Miniverse” me shifër 8401 për projekt propozimin e OE pjesëmarrës me shifër 2107, ku në lidhje me pretendimin ankimor se juria me anë të vlerësimit të projektit të Operatorit Ekonomik me shifër 2107, me pikë në vendin e parë në kundërshtim me kërkesat - Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE dhe/ose estetike TË DETYRUESHME - detyrës projektuese për konservimin dhe adaptimin e ndërtesës si dhe me parimet themelore profesionale të konservimit të monumenteve, me Ligjin nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore, dhe atë: Ndërtimi i objektit ngjitur për monument/ Info-point, paneli shqyrtues konstaton se operatori ekonomik gjatë hartimit të projektit nuk e ka respektuar detyrën projektuese në bazë të së cilës kërkohet që të bëhet: Largimi i anekseve të cilat ndodhen në zonën e mbrojtur të ndërtesës dhe që me arkitekturën e tyre ndikojnë negativisht në integritetin e ndërtesës në zonën historike, kurse OE me shifër 2107 në projekt propozimin e dorëzuar nuk i respekton kriteret të kërkuara me specifikacionin teknik të detyrueshëm- tek Detyra projektuese respektivisht Kërkesat specifike të Dizajnit në të cilën kërkohet: Të largohen anekset e ndërtuara më vonë dhe të kthehet hapësira përreth ndërtesës në hapësirë publike të gjelbëruar që mund të përdoret nga të gjitha komunitetet, kurse OE me shifër 2107 në projekt propozimin e dorëzuar parasheh që në këtë zonë të ndërtoj një objekt me funksion për “InfoPoint” i cili është propozuar që të jetë i ngjitur me objektin cili është në mbrojtje të trashëgimisë kulturore kështu që ndikon drejtpërsëdrejti në integritetin e ndërtesës si dhe në fshehjen e detajeve arkitekturore të trashëgimisë, andaj duke u bazuar në dëshmitë e lartpërmendura paneli shqyrtues konstaton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ” Miniverse” sh.p.k. se juria me anë të vlerësimit të projektit të Operatorit Ekonomik me shifër 2107, me pikë në vendin e parë ka rënë në kundërshtim me kërkesat- Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE dhe/ose estetike TË DETYRUESHME - detyrës projektuese për konservimin dhe adaptimin e ndërtesës si dhe me parimet themelore profesionale të konservimit të monumenteve, me Ligjin nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore, dhe atë: Ri- adaptimi i lokaleve- ndërtimi i lokaleve të reja, paneli shqyrtues pas analizimit të detyrës projektuese ligjit për Trashëgiminë Kulturore, si dhe projektit të propozuar paneli shqyrtues konstaton se pretendimi ankimor është i qëndrueshëm pasi që operatori ekonomik gjatë hartimit të projektit nuk e ka respektuar detyrën projektuese në bazë të së cilës kërkohet që të bëhet - Largimi i anekseve të cilat ndodhen në zonën e mbrojtur të ndërtesës dhe që me arkitekturën e tyre ndikojnë negativisht në integritetin e ndërtesës në zonën historike; kurse OE me shifër 2107 në projekt propozimin e dorëzuar nuk i respekton kriteret të kërkuara me specifikacionin teknik të detyrueshëm- tek Detyra projektuese respektivisht- Kërkesat specifike të Dizajnit në të cilën kërkohet: Të largohen anekset e ndërtuara më vonë dhe të kthehet hapësira përreth ndërtesës në hapësirë

publike të gjelbëruar që mund të përdoret nga të gjitha komunitetet, kurse OE me shifër 2107 ne projekt propozimin e dorëzuar parasheh që në këtë zonë të ndërtoj objekte apo ti Ri- adaptoj ato ekzistueset.

Lidhur me pretendimin e OE "Miniverse" sh.p.k se juria me anë të vlerësimit të projektit të Operatorit Ekonomik me shifër 2107, me pikë në vendin e parë ka rënë në kundërshtim me kërkesat - Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE dhe/ose estetike TË DETYRUESHME - detyrës projektuese për konservimin dhe adaptimin e ndërtesës si dhe me parimet themelore profesionale të konservimit të monumenteve, me Ligjin nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore, dhe atë: Vendosja e gardheve në hapësirë publike, paneli shqyrtues konstaton se ky pretendim ankimor është i qëndrueshëm për faktin se operatori ekonomik gjatë hartimit të projektit nuk e ka respektuar detyrën projektuese në bazë të së cilës kërkohet që të krijohen hapësira publike të gjelbëruar në mjedisin përreth ndërtesës si dhe të largohen anekset e ndërtuara më vonë dhe të kthehet hapësira përreth ndërtesës në hapësirë publike të gjelbëruar që mund të përdoret nga të gjitha komunitetet dhe jo të kufizohet me gardhe apo të bëhet ndarja me rrethoj e dy objekteve të trashëgimisë kulturore siç është objekti i Ish kadastrit dhe ai i shkollës së parë shqipe.

Lidhur me pretendimin e OE "Miniverse" sh.p.k se juria me anë të vlerësimit të projektit të Operatorit Ekonomik me shifër 2107, me pikë në vendin e parë bie në kundërshtim me kërkesat - Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE dhe/ose estetike TË DETYRUESHME - detyrës projektuese për konservimin dhe adaptimin e ndërtesës si dhe me parimet themelore profesionale të konservimit të monumenteve, me Ligjin nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore, dhe atë: Shtimi i funksioneve jashtë kërkesës së detyrës projektuese, paneli shqyrtues konstaton se operatori ekonomik gjatë hartimit të projektit e ka respektuar detyrën projektuese në bazë të së cilës janë përcaktuar hapësirat të cilat duhet përmbaj zgjidhja e propozuar duke e respektuar sipërfaqen e vogël shfrytëzuese të objektit operatori ekonomik në projektin e propozuar ka paraparë kthina të cilat janë të nevojshme për plotësimin e nevojave për këtë lloj objekti, andaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE "Miniverse" sh.p.k. se juria me anë të vlerësimit të projektit të Operatorit Ekonomik me shifër 2107, me pikë në vendin e parë bie në kundërshtim me kërkesat - Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE dhe/ose estetike TË DETYRUESHME - detyrës projektuese për konservimin dhe adaptimin e ndërtesës si dhe me parimet themelore profesionale të konservimit të monumenteve, me Ligjin nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore, dhe atë: Parkingu nëntokësorë në parcelën e Komunës së Prishtinës paneli shqyrtues konform mendimit të ekspertit shqyrtues teknik konstaton se operatori ekonomik gjatë hartimit të projektit nuk e ka respektuar detyrën projektuese sepse parcela për trajtim që

është dhënë me detyrën projektuese është e vogël për të paraparë parking nëntokësor njëherit kjo është zonë trashëgimisë kulturore në të cilën nuk lejohet të ndërtohen objekte të reja dhe sipas detyrës projektuese është kërkuar të bëhet largimi i anekseve të cilat ndodhen në zonën e mbrojtur të ndërtesës dhe që me arkitekturën e tyre ndikojnë negativisht në integritetin e ndërtesës në zonën historike, andaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE "Miniverse" s.hp.k. – ankues se Autoriteti Kontraktues-juria, në raportin e vlerësimit ka trajtim të pabarabartë dhe indikativ ndaj nesh si Operatorë Ekonomik 8041. Përderisa arsyet e poentimit duhet që të reflektojnë në numrin e poenave për secilit operator, te ne- Operatori Ekonomik 8041, ndodhë e kundërta! Edhe pse në arsyet e poentimit thuhet se i kemi përmbushur Kriterin Estetik dhe Ekologjik, poentohemi me më pak pikë se OE 5044, që thuhet se nuk e ka përmbushur këtë kriter. Kjo ndodhë edhe në Kriterin Hapësinorë, ku Operatori 5044 nuk përmbushë këtë kriter dhe prapë i janë dhënë më shumë pikë se ne (8401)- që e përmbushim këtë kriter. Kjo pabarazi në vlerësim, kjo mos-përputhje ka ndikuar që OE 5044 në mënyrë jo meritore të ketë më shumë pikë dhe të rreshtohet para nesh (në vend të dytë), paneli shqyrtues konform mendimit të ekspertit shqyrtues teknik konstaton se gjatë analizës së raportit të vlerësimit të jurisë respektivisht Arsyet e poentimit për Kriter Estetik (vlera në pikë = 20 pikë) shifra 5044 vlerësohet: "Vlera dhe origjinaliteti i trashëgimisë arkitektonike të ndërtesës në fjalë sipas projektit. Në dukjen e jashtme dhe pjesërisht të brendshme është arrit të respektohet mesatarisht brenda kontekstit kulturor të cilit i përket, si dhe duke u bazuar në dokumentet e gjetura me të cilat posedojnë institucionet relevante të trashëgimisë" dhe poentohet me pikë mesatare të tre anëtarëve të Jurisë $\{(14+12+14)/3= 13.33 \text{ pike}\}$. Kurse Operatori Ekonomik me shifër 8041 vendin e dytë e vlerësohet: "Vlera dhe origjinaliteti i trashëgimisë arkitektonike të ndërtesës në fjalë sipas projektit në dukjen e jashtme respektivisht dukja - modeli i dritareve të propozuara nuk respekton dukjen autentike duke u bazuar në dokumentet e gjetura me të cilat posedojnë institucionet relevante të trashëgimisë, pjesët tjera përbërëse të dukjes përshtaten me kriteret e ruajtjes dhe është e pranueshme." Poentohet me pikë mesatare të tre anëtarëve të Jurisë $\{(15+15+15)/3= 15 \text{ pikë}\}$ paneli shqyrtues konstaton se në bazë të vlerësimit të bërë nga komisioni për vlerësim të Kriterit Estetik të projektit të dorëzuar nga Operatori Ekonomik "Miniverse" sh.p.k. me shifër 8041 me 13.33 pikë nga 20 pikë të peshuara për këtë kriter i cili vlerësohet në këtë mënyrë: "...është arrit të respektohet mesatarisht brenda kontekstit kulturor ..." sqaron se OE ankues është dashtë të vlerësohet me pikë më shumë se sa projekt propozimi Operatorit Ekonomik me shifër 5044 për kriterin Estetik dhe Ekologjik te cilin komisioni e ka vlerësuar: "... nuk respekton dukjen autentike duke u bazuar ne dokumentet e gjetura me të cilat posedojnë e institucionet

relevante të trashëgimisë ...” dhe të cilën e ka vlerësuar me 15 pikë nga 20 pikë të peshuara për këtë kriter, prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Paneli shqyrtues vlerëson se AK në zhvillimin e kësaj procedurë të prokurimit nuk ka vepruar në harmoni me nenin 59 të LPP-së për shkak se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë konform këtij neni për arsyt e cekura si më lart, andaj paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z. Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK - Kuvendi Komunal Prishtinë
- 1x1 OE - "Miniverse"shpk-Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ëeb- faqe të OSHP-së.